



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 496 Prot.

Tiranë, më datë 22.01.2020

VENDIM

Nr. 24, datë 22.01.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 22.01.2020,

VENDOSI:

1. Mos miratimin e projektit “Rindërtim, vila Strugu, në Qendrën Historike Voskopojë”, me investitor z. Luftim Sheno, hartuar nga Ark. Rest. Pirro Thomo, me argumentat si më poshtë:
 - Objekti ndodhet brenda Qendrës Historike të Voskopjës, shpallur me Vendim Nr. 673, datë 10.10.2007. Projekti duhet t’i përmbahet kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e Qendrës Historike, neni 15. Gjendja ekzistuese e objektit është rrënojë rreth 30 m². Ky projekt parashikon ndërtim të ri. Sipas rregullores së Qendrës Historike, rindërtimet apo konstruksionet e reja lejohen vetëm kur zëvendësojnë ato ekzistuese si shkolla, kopshte, çerdhe, zyra. Lartësia e godinës deri në kulmin e çatisë është +8.50 m nga kuota e terrenit. Lartësia e lejuar e katit të parë është 2.4 – 2.6 m, ndërkohë që propozohet 3.06 m. Kati i dytë i nënçatisë parashikohet i shfrytëzueshëm.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

K R Y E T A R

Elva MARGARITI

